



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1079 / Prot. 3

Vlorë më, 02.05.2024

VENDIM

Nr. 22, datë 02.05.2024

PËR

**MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË TË GJITHA
PROGRAMET E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 6, pika 30, pika 2, nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr.228, datë 21.05.2018 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të studimit të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" si dhe referuar shkresës së Administratorit të UV-Së me nr.1017, prot, datë 26.04.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.05.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e shkollimit për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Studentët e ciklit të parë të studimeve i nënshtrohen vetëm një tarife shkollimi.
3. Studentët e ciklit të parë të studimeve në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që rezultojnë me notë mesatare nën 6 në përfundim të vitit të parë akademik e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit.
4. Studentët të cilët rezultojnë me notë mesatare të vitit paraardhës mbi 6(gjashtë)- 9(nëntë) paguajnë ½ tarifës së shkollimit.
5. Studentët e ciklit të parë të studimeve të cilësuar përsëritës dhe vijnë studimet në vitin pasardhës i nënshtrohen tarifës së plotë të shkollimit të vitit akademik në të cilin ndjek studimet.
6. Për studentët e ciklit të dytë të studimeve afatet dhe mënyra e pagesës do të jetë në zbatim të vendimit të BA nr.52 datë 19.11.2020.
7. Për studentët që ndjekin një program të integruar të studimit afatet dhe mënyra e pagesës do të jetë në zbatim të vendimit BA nr. 19, datë 11.05.2021.
8. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Asoc.Xhiliola Agaraj (Shehu)

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Faqe 1 nga 1

Web-site: ee.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

